

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti kryetar, Dr.sc.Driton Muharremi e Mejreme Memaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonita Lajçi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.B. nga fsh..... K.Gjilanit, për shkak të veprës penale Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.B. av. S.K., kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.141/18 të datës 05.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 12.02.2019 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.141/18 të datës 05.12.2018, **vërtetohet.**

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan me aktgjykimin PKR.nr.141/18 të datës 05.12.2018 e ka shpallur fajtor të akuzuarin B.B. për shkak të veprës penale Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim me gjobë në lartësi prej 1000 (një mijë) euro dhe dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim me gjobë do të paguaj përkatësisht dënimin me burgim do ta mbajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit. Në dënimin e shqiptuar me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 22.06.2018 deri me 20.07.2018. Të akuzuarit i shqiptohet dënim plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik në kohëzgjatje prej 1(një) viti, pas mbajtjes së dënimit me burgim. I dëmtuari Arbër Emini për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil. Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësorë ne shumë prej 50 euro si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare si dhe 50 euro për Kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit B.B. av. S.K. për shkak për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit B.B. ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim të zëvendësohet më dënim me gjobë, sa i përket dënimit me gjobë të shqiptohet dënim më i butë, apo të anulohet dhe lënda të kthehet ne rigjykim.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezent ishin i akuzuari B.B., dhe mbrojtësi i tij av. S.K., kurse nuk prezantoi Prokurori i Apelit dhe i dëmtuari A.E. edhe pse ishin te ftuar me rregull për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës. Mbrojtësi mbeti pranë pretendimeve ankimore të parashtruara me shkrim, kurse i akuzuari B.B. mbështeti fjalët e mbrojtësit duke shtuar se i njëjti është shumë i shqetësuar dhe i izoluar nga familja dhe shoqëria.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.50/19 të dt. 28.01.2019 ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.B. av. S.K. dhe aktgjykimi ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

#### **-ankesa është e pa bazuar**

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B. av. S.K., në ankesë thekson se në këtë aktgjykim qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 233 par.16, 18, 21 dhe 22 të KPP-së pasi që Prokurori i shtetit dhe i akuzuari B.B. kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sipas marrëveshjes në fjalë palët janë pajtuar që dënimi me burgim të jetë në kohëzgjatje prej 180 ditësh me mundësi zëvendësimi me dënim me gjobë konform nenit 47 të KPRK-së, mirëpo Gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas marrëveshjes në fjalë pra gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 248 par.4 të KPP-së e cila dispozitë zbatohet vetëm në rastet kur i pandehuri pranon fajësinë ne shqyrtimin fillestarë pra vetëm kur nuk ekziston marrëveshja me shkrim për pranimin e fajësisë. Duke vepruar në këtë mënyrë nga arsyet e lartcekura gjykata e shkallës së parë ka shkelur edhe të drejtën materiale në dëm të akuzuarit të parashikuar nga neni 385 par.1 nënpar.1.5 të KPP-së.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.B., si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale por as shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare është e obliguar ti shqyrtojë. Kjo për faktin se pretendimi i mbrojtjes se kemi një marrëveshje për pranimin e fajësisë në mes të Prokurorit dhe mbrojtjes dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas marrëveshjes në fjalë dhe se gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 248 par. 4 të KPP-së, është e pa bazuar. Nga shkresat e lëndës shihet se kemi një marrëveshje për pranimin e fajësisë mes Prokurorit dhe mbrojtjes, marrëveshje kjo e ushtruar konform nenit 233 të KPP-së mirëpo nga procesverbali i dt. 05.12.2018 shihet se Gjykata e shkallës së parë duke vepruar konform nenit 233 par.20 të KPP-së ka refuzuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë pasi nuk është bindur se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në nenin 18 të këtij neni ashtu që ka vazhduar me gjykim të rregullt siç parashihet me këtë kod. Prandaj në një situatë të tillë nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtësit se nuk është vepruar lidhur me marrëveshjen për pranim të fajësisë dhe si të tillë kjo Gjykatë këtë pretendim e ka refuzuar si të pa bazuar.

Meqë aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Duke shqyrtuar çështjen përkritazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtjes nuk janë të bazuara. Në ankesën e mbrojtësit nuk theksohen fakte dhe rrethana të reja e të cilat nuk i ka pasur Gjykata e shkallës së parë por vetëm shton se dënimi është shumë i rëndë duke pas parasysh se i njëjti ka një gjendje të mesme ekonomike, është i pa punë, baba i tre fëmijëve ku dy prej tyre janë të mitur dhe se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me një dënim më të butë. Mirëpo duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rëndues të vlerësuara drejtë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë edhe atë: si rrethanë lehtësuese se i akuzuari e ka pranuar fajësinë duke shprehur keqardhje të thellë, se i njëjti kishte sjellje të mira në gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale duke i kërkuar publikisht falje të dëmtuarit, ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale si fenomen që dëmton shoqërinë në përgjithësi dhe individin në veçanti, se vepra penale është kryer me dashje direkte dhe duke insistuar tek i dëmtuari disa herë përmes telefonit që të ja jepte paratë, vlerëson se dënimi i shqyrtuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

PAKR.nr.40/2019, më 12.02.2019

Procesmbajtës,  
Leonita Lajçi

Kryetar i kolegjit- gjyqtari  
1. Abdullah Ahmeti \_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi \_\_\_\_\_

3. Mejreme Memaj \_\_\_\_\_